



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

**Legjislatura e III-të**

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,  
Kulturë, Rini e Sport  
Mbledhja e datës 09.06.2008  
Salla nr. N.10 ora 13,00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Memli Krasniqi, Vlora Çitaku, Adem Hajdaraj, Heset Cakolli, Fatmire Berisha, Donika Kadaj-Bujupi Mark Krasniqi dhe Dragan Dimiq.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkagjiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu, kryetar i Komisionit.  
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2.. Shqyrtimi i Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

## **1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.**

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte.**

Në fillim të mbledhjes kryetari i Komisionit Agim Veliu, i shprehu mirëseardhje anëtarit të ri të këtij Komisioni nga radhët e minoritetit serb Dragan Dimiq.

**Agim Veliu**, kryetar i Komisionit, kërkoi që referuesit e Projektligjit për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte të paraqesin sygjerimet e tyre lidhur me Projektligjin.

**Drita Kadriu** shpjegoi opinionet e saj lidhur me Projektligjin, si dhe qëndrimet joformale të grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit. Ajo tha se nga dëgjimi publik i organizuar për këtë Projektligj kemi marrë informacione të mjaftueshme si nga ekspertët e ftuar, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Kulturës se Projektligji nuk përmbushë kërkesat e tij pasaçërisht neni 12 i cili parasheh lehtësirat tatimore të sponsoruesit.

Nga takimet me përfaqësuesit e MEF-it ka është kërkuar që projektligji të rishikohet edhe një herë.

Nga këto paqartësi mendon që Projektligji duhet t'i kthehet Qeverisë në ripunim.

**Donika Kadaj Bujupi**, në cilësinë e referueses së Projektligjit konsideron se në bazë të të dhënave dhe vërejtjeve të ekspertëve Projektligji ka paqartësi dhe se duhet t'i kthehet sponsoruesit në ripunim.

**Vlora Çitaku** shpjegoi takimet e grupit punues të referuesve me Ministrin e Kulturës dhe grupet e interesit që i mbulon ky Projektligj. Vërejtjet në përgjithësi përkojnë me nenin 12 të Projektligjit. Nga takimet me MEF-in dhe MASHT-in është paraparë që ky projektligj të ripunohet edhe një herë në mënyrë që të përfshihen edhe fushat e tjera të sponzorimit si arsimit shkenca teknologjia.

Më tej sqaroi se Qeveria është në fazën e hartimit të pakos fiskale që do të implementohet nga janari i vitit 2009 dhe që do të ndikojë edhe në këtë Projektligj.

**Heset Cakolli** njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi parlamentar i AKR-së ka organizu një dëgjim publik lidhur me këtë Projektligj. Nga dëgjimi publik ka pasur opinione që Projektligji si i tillë duhet të tërhiqet nga Qeveria ngase si i tillë vështirë se mund të implementohet.

**Memli Krasniqi** i caktuar nga Komisioni si referues i tretë i Projektligjit tha se nga takimet me ekspertë dhe përfaqësuesit e biznesit është parë se projektligji ka vërejtje dhe si i tillë nuk mund të implementohet, ngase neni 12 i tij parasheh lehtësira në tatim që është në kundërshtim me sponzorimet. Ai mendon se ky projektligj duhet ti kthehet Qeverisë dhe që i njëjti të hartohet me inkorporimin edhe të fushave të tjera të sponzorimit siç është arsimit, shkenca.

**Mark Krasniqi** në diskutimin e tij tha se meqë sponzorimi është një aksion vullnetar, kjo çështje do duhej të rregullohet me ndonjë rregullore e jo me ligj.

Pas diskutimit të referuesve të Projektligjit dhe anëtarëve të Komisionit, me shumicë votash u nxorr ky:

## P e r f u n d i m

Projektligji për Sponzorimet në Kulturë, Rini e Sporte t'i kthehet Qeverisë në ripunim. I njëjti duhet të përfshijë më shumë fusha të sponzorimit si dhe të ndryshohet neni 12 lidhur me lehtësirat në bizneset.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.**

Lidhur me këtë Projektligj Komisioni ka ngarkuar tre referues Drita Kadriu Enis Kervan dhe Adem Hajdaraj

**Drita Kadriu** si referuese kishte dilema lidhur me titullin dhe përmbajtjen e Projektligjit. Ajo tha se ka paqartësi në Projektligj lidhur me veprimtarinë dhe funksionimin e ansambleve të qyteteve të tjera duke pasur parasysh se ansamblin e këngëve dhe valleve Shota e themelon Kuvendi i Kosovës, ndërsa për ansamblet e tjera duhet të përcaktohet themelimi, veprimtaria dhe funksionimi i tyre.

Më tej ajo shpjegoi se ka punuar në amendamentimin nen për nen dhe se kërkon nga Komisioni që bashkarisht të merret një qëndrim lidhur me titullin dhe përmbajtjen e Projektligjit.

**Adem Hajdaraj** si referues kishte qëndrim që Projektligji të jetë vetëm për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Shota, ndërsa veprimtaria e ansambleve të tjera të rregullohet me një ligj apo rregullore tjetër.

**Vlora Çitaku** mendon se ky projektligj është konfuz ngase i referohet edhe ansamblit Shota edhe ansambleve të tjera dhe lidhur me këtë do të ishte mirë të merret si referencë Ligji për Teatrin në mënyrë që të shikohet si është rregulluar çështja dhe organizimi i teatrove komunale.

**Memli Krasniqi** tha se Projektligji në fjalë rregullon ekskluzivisht Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Shota kjo shihet edhe nga memorandumimi shpjegues si dhe nga brendia e Projektligjit. Ai është i mendimit se veprimtaria e ansambleve të tjera duhet të rregullohet me ndonjë rregullore tjetër.

**Enis Kervan**, referues ishte i mendimit se Projektligjit ose i duhet ndryshuar titullin dhe të hartohet ndonjë ligj tjetër për ansamblet komunale ose të merret modeli i funksionimit të teatrove komunale nga Ligji për Teatrin, dhe të amendamentohet në bazë të tij.

**Donika Kadaj - Bujupi** tha se ky Projektligj do duhet të amendamentohet vetëm për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Shota, ndërsa për Ansamblet e tjera duhet gjetur zgjedhje tjetër.

**Agim Veliu**, kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen për shqyrtimin dhe amendamentimin e mëtejme të këtij Projektligji, me leximin dhe krahasimin e tij me Ligjin për Teatrin.

Komisioni vendosi që të analizojë themelimin dhe veprimtarinë e teatrove komunale në Ligjin për Teatrin, dhe gjer të hënën e ardhshme të fillojë me amendamentimin e Projektligjit për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Shota dhe të Ansambeve të tjera.

#### **4. Të ndryshme**

Anëtarët e Komisionit, Memli Krasniqi, Enis Kervan dhe Vlora Çitaku njoftuan anëtarë e tjerë të Komisionit lidhur prezencën e tyre në testin e maturës, me nivelin e organizimit të testit dhe vlerësimin e tyre për mbajtjen e testit të maturës sipas Ligjit për Provimin Përfundimtar dhe të Maturës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës ditë më parë.

Mbledhja e ardhshme e Komisionit do të mbahet të hënën e ardhshme më datë 16.06.08 në orën 13,00 me shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Mbledhja përfundoi në orën 14,15

Kryetari i Komisionit  
Agim Veliu